



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 1065 Prot.,

Datë 13.11.2023

URDHËR

Nr. 77, Datë 13.11.2023

PËR

**“MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR VITET 2023-2025 PËR
AGJENCINË SHQIPTARË TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 23, germa e, të Statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), miratuar me vendimin nr. 2, datë 04.02.2011, të Bordit Drejtues, të Vendimit nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247, datë 30.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015 – 2020” dhe Miratimin e Planit të Veprimit 2020 – 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2023 e të Pasaportës së Indikatorëve’,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për vitet 2023-2025, për Agjencinë Shqiptarë të Zhvillimit të Investimeve, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Publikimin e menjëhershëm të Planit të Integritetit për njohje në faqën zyrtare të institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

LAURA PLAKU (SARO)



PLANI I INTEGRITETIT

PËR

AGJENCINË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË

INVESTIMEVE (AIDA)

VITI 2023-2025

Tetor 2023, Tiranë

Përmbajtja

1. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

- 1.1 Përshkrim i shkurtër për institucionin
- 1.2 Baza Ligjore dhe materiale referuese
- 1.3 Ngritja e Grupit të Punës
- 1.4 Koncepti “Integritet”
- 1.5 Informacion i shkurtër mbi Planin e Integritetit
- 1.6 Plani i Integritetit për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

2. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE

- 2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve
- 2.2 Veprimtaria brenda institucionit

3. RISQE TË PËRGJITHSHME

- 3.1 Risqet lidhur me konfliktin e interesit
- 3.2 Risqet lidhur me informimin
- 3.3 Risqet lidhur me transparencën
- 3.4 Risqet lidhur me etikën
- 3.5 Risqet lidhur me korrupsionin

4. PLANI I VEPRIMIT

- 4.1 Përmbledhje
- 4.2 Monitorimi

1. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

1.1 Përshkrim i shkurtër për institucionin

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është themeluar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010, “Për themelimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”.

AIDA është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Fokusi i agjencisë është të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

Si ndërmjetës i Qeverisë Shqiptare me investitorët e huaj, AIDA siguron qasje në informacion, dhe shërben si një “One-Stop-Shop”, duke mbështetur investitorët gjatë gjithë procesit të investimit.

Kontributi i drejtpërdrejtë i AIDA-s në zhvillimin ekonomik të vendit theksohet përmes:

1. **Lehtësimit** dhe mbështetjes së investimeve të drejtpërdrejta në Shqipëri.
2. **Rritjes** dhe konkurrencës së Ndërmarrjeve, Mikro, të Vogla dhe të Mesme, (NMVM).
3. **Promovimit** dhe ofrimit të ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme për zhvillimin e sektorit privat dhe për përmirësimin e klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre të biznesit, përmes ndërhyrjes dhe bashkëpunimit me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Organi më i lartë vendimarrës i këtij institucioni është Bordi Drejtues. Struktura organizative e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është përcaktuar me Vendimin nr. 3, datë 17.06.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” të Bordit Drejtues të AIDA-s.

Administrata e AIDA-s kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv, si ka në përbërje 5(pesë) Drejtori dhe struktura të tjera.

1.2 Baza ligjore dhe materialet referuese

1. Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;
2. Ligji nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
3. Legjislacioni në fuqi në fushën e prokurimit publik, auditimit, inspektimit të financave publike etj.
4. Vendimi nr. 516, datë 1.7.2020 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të

Verpimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve””;

5. Urdhri nr. 334, datë 7.10.2020 i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”;

1.3 Ngritja e Grupit të Punës

Me urdhër nr.19, datë 14.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv, u ngrit Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit të AIDA-s për vitin 2023-2025, të përbërë nga drejtorët e drejtorive të përmbajtjes dhe të drejtorisë së shërbimeve mbështetëse.

1.4 Koncepti “Integritet”

Integriteti konsiston në përmbushjen e disa karakteristikave për një qeverisje të përgjegjshme dhe përbën një parakusht për ligjshmërinë e veprimeve të qeverisë, në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

Sipas dokumentit teknik të Këshillit të Europës për metodologjinë e vlerësimit të riskut, disa nga format e shkeljes së integritetit janë:

- Korrupsioni;
- Përvetësimi, shpërdorimi, devijimi i fondeve publike;
- Trajtimi i qytetarëve në mënyrë të pabarabartë ose të pa drejtë;
- Kërkesat dhe procedurat e tepërta administrative;
- Mosrespektimi i procedurave/respektimi i kërkesave ligjore;
- Mungesa e profesionalizmit gjatë ushtrimit të detyrave;
- Neglizhenca.

Risku i integritetit përbën efektin e pasigurisë për objektivat organizative të institucionit, të shkaktuar nga korrupsioni dhe shkeljet e integritetit, si dhe lidhet me mundësinë e përditshme të ndodhjes së një ngjarjeje me ndikim në integritetin e institucionit.

1.5 Informacion i shkurtër mbi Planin e Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operativ, i cili i shërben institucionit për identifikimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve, që çënojnë integritetin e institucionit, zyrtarëve dhe nëpunësve publikë. Pra, shërben si një dokument pune, ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

Në kuadër të reformave të administratës publike, rezultojnë të rëndësishme forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion. Qëllimi i vlerësimit të riskut është

identifikimi i risqeve “të sjelljes” brenda institucionit, që kompromenton aftësinë e tij për të kryer funksionin e shërbimit publik, në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.

Roli i rëndësishëm që ka Plani i Integritetit përfshin përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, forcimin e rezistencës institucionale ndaj çënimeve të integritetit, si dhe planifikimin e menaxhimit të riskut të integritetit.

1.6 Plani i Integritetit për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Plani i Integritetit u hartua gjatë vitit 2023 dhe i sjell efektet e tij për vitet 2023-2025.

Misioni i hartimit të këtij akti është përfshirja e analizës sistematike të riskut, sipas fushës së përgjegjësisë së institucionit, si dhe formulimi i masave të përshtatshme për përmirësimin e performancës së nëpunësve të magjencisë, llogaridhënies dhe transparencës së institucionit.

Hartimi i dokumentit është kryer nga Grupi i Punës, mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për qeverisjen vendore. Gjatë këtij procesi, janë angazhuar dhe kanë kontribuar të gjitha strukturat e brendshme të Agjencisë, për aq sa mbulon fusha e tyre e përgjegjësisë.

Me qëllim përgatitjen e materialit, u përcaktua një plan pune, i cili përfshinte çështje si:

- Evidentimi i problematikave kryesore dhe risqeve bazë të integritetit të institucionit sipas njësive me të cilat është e organizuar Agjencia;
- Informimi i drejtorive për mbledhjen, përpunimin e administrimin e të dhënave/informacioneve në lidhje me risqet e integritetit, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre;
- Dhënia e udhëzimeve orientuese;
- Koordinimi i kontributit të drejtorive në lidhje me identifikimin e risqeve të përgjithshme si ato të konfliktit të interesit, shkëljes së Kodit të Etikës dhe transparencës, informimit, konsultimit publik;
- Përpunimi i të dhënave të përfituara nga identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi i risqeve të integritetit;
- Nxjerrja e konkluzioneve, rekomandimeve.

2. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE

2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve apo ngjarjeve të shkeljes së integritetit, është trajtuar dhe harmonizuar kontributi i strukturave të Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, duke u përqëndruar më së shumti tek identifikimi i faktorëve, burimeve, ndikimit dhe shkaktarëve. Gjithashtu, është mbajtur në konsideratë vlerësimi i risqeve, për të kuptuar mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve të papërshtatshme.

Gjatë kësaj faze, Grupi i Punës i kushtoi vëmendje aspekteve ligjore dhe rregullatore të institucionit, duke u bazuar në çështje të tilla si analiza, mbledhje informacionesh dhe koordinime.

2.2 Veprimtaria brenda institucionit

Bazuar në strukturën organizative aktuale të Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve, është arritur të formulohet një kuadër i përgjithshëm rregullator, sipas përgjegjësive dhe funksioneve që mbulojnë drejtoritë e këtij institucioni. Analiza e detajuar është kryer për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim për shkak të ekspozimit ndaj risqeve.

Ky seksion i Planit të Integritetit i dedikohet identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit të risqeve, për drejtoritë e Agjencisë.

- **Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse** (ose drejtoria/struktura përgjegjëse për fushën e financës, burimeve njerëzore, arkiv protokollin dhe administratën)

Funksionet kryesore të kësaj drejtorie lidhen me krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin normal të proceseve të punës, si dhe të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik – financiar dhe administrativ të Agjencisë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Referuar dhe Manualit të Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit kjo njësi aktualisht mbulon proceset e punës që përbëjnë dhe fushat më vulnerable për cënimin e integritetit të nëpunësve.

Konkretisht disa nga funksionet kryesore të kësaj njësie lidhen me:

- përgatitjen e projektbuxhetit për nevojat e Agjencisë dhe ndjek zbatimin e tij
- menaxhimin e burimeve njerëzore dhe respektimin e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore për kushtet, procedurat, të drejtat dhe detyrimet e pranimit, fillimit, vazhdimin dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve në Agjenci, zbatimin e disiplinës dhe rregullave të etikës nga punonjësit,
- mbështetjen e veprimtarisë të Agjencisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjeve të BE, marrëveshjeve ndërkombëtare, duke siguruar gatishmëri dhe garanci materiale e logjistike dhe drejtuar shërbimet e stafit ndihmës dhe teknik;
- ndjekjen e procesit të deklarimit të pasurive dhe këshillimin e punonjësit të institucionit në fushën e konfliktit të interesit;
- shërbimin e prokurimit në bashkëpunim me njësitë e tjera organizative të Agjencisë.

Duke qenë se puna e kësaj drejtorie konsiderohet një nga shtyllat e institucionit dhe ka impakt në integritetin e tij në tërësi, vlerësohet e rëndësishme që të vepohet me saktësi, paanësi dhe përgjegjshmëri, në drejtim të menaxhimit në tërësi të proceseve që lidhen me përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, menaxhimin e fondeve të akorduara në planin vjetor, përcaktimin e saktë të procedurave të prokurimit të fondeve sipas legjislacionit në fuqi, manaxhimi i burimeve njerëzore duke vlerësuar potencialin e tyre dhe nevojat për trajnime.

Nga analiza e kryer për nga fushat e veprimtarisë të kësaj njësie, rezulton se:

-Në fushën e manaxhimit financiar, regjistrimet e veprimeve financiare si: lëvizjet e aktiveve afatshkurtëra dhe ato afatgjata, regjistrimi i transaksioneve financiare të kryera me ark dhe bank, si dhe çdo informacion tjetër financiar, përpunohet në format exel.

Rekomandohet futja e një sistemi financiar (soft) për mbajtjen e kontabilitetit në mënyrë që informacioni financiar të jetë më i aksesueshëm dhe të japi mundësi për prodhimin e raporteve financiare në kohë reale.

-Në fushën e manaxhimit të burimeve njerëzore, struktura përgjegjëse në AIDA për manaxhimin e burimeve njerëzore, ndjek proceset e rekrutimeve në respektim të parimeve të transparencës dhe mosdiskriminimit. Njoftimet për vendet vakante bëhen publike në faqen zyrtare të AIDA-s, ku specifikohen të gjithë elementet e nevojshëm për dijëni të kandidatëve potencial, në mënyrë që procesi i rekrutimit të mos çenojë integritetin e institucionit. Nga analiza e kryer për këtë fushë është vlerësuar se risk mbart mungesa e fondeve për mbulimin e nevojave për trajnime për stafin për rritjen e tyre profesionale, duke patur si fokus objektivat e institucionit.

Rekomandohet që njësit e AIDA-s të jenë të kujdesshëm në përcaktimin e nevojave për trajnime të stafit gjatë procesit të plotësimit të formularit të vlerësimit të punonjësve, si dhe të reflektohen kostot e nevojshme për këto trajnime në hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm (PBA).

- Në fushën e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit, AIDA nuk ka një mekanizëm të mirëfillt në nivel strukturor të auditimit të brendshëm për vetë faktin se organika aktuale e Agjencisë nuk e mundëson. Nga ana tjetër, duke qenë se jemi institucion në varësi të Ministrisë së Fiancave dhe Ekonomisë, kryejmë tek kjo e fundit raportime të vazhdueshme në lidhje me monitorimin e buxhetit, mbi manaxhimin e burimeve njerëzore, rekrutimet, vakancat, rregulloret e brendshme etj.

Lidhur me mekanizmat për shmangien e korrupsionit dhe konfliktin e interesit, AIDA zbaton rregullat e përcaktuara në ligjin për prokurimet publike si, ngritjen e strukturave të nevojshme të cilat siguroheni që nuk janë në kushtet e konfliktit referuar përcaktimeve të Ligjit “Për manaxhimin financiar dhe të kontrollit”. Gjithashtu, sipas rastit, anëtarët e komisioneve të prokurimeve publike nënshkruajnë deklarata që konfirmojnë se nuk janë në kushte të konfliktit të interesit.

Rekomandohet që të sigurohet se punonjësit në momentin e emërimit në detyrë të informohen mbi kuadrin ligjor që lidhet me parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike (Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005).

- Në fushën e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik, AIDA aktualisht nuk ka sistem elektronik të mbajtjes së informacionit të fondit të arkivës. Rregullat e mbajtjes së arkivës i nënshtrohen ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Sistemi i qarkullimit të shkresave zyrtare dhe dokumentave të tjera nuk ka një rregullore të identifikuar dhe miratuar nga AIDA.

Rekomandohet hartimi i një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e mënyrës së qarkullimit të shkresave zyrtare dhe të administrimit të tyre nga punonjësit deri në procesin e arkivimit të praktikave në përfundim të administrimit të tyre.

- **Drejtoria e NVM dhe Projekteve** (ose drejtoria/struktura përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, ndërtimit të kapaciteteve, informacionit mbi tregjet, doganat, etj, në kuadër të rritjes së aftësisë inovative dhe teknologjike të NVM-ve dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm për inovacionin).

Aktualisht kjo drejtori ka në përbërje të saj 2(dy) sektorë, *Inovacion dhe Projekte & NVM dhe Eksporte*.

Disa nga funksionet kryesore të kësaj njësie, lidhen me:

- Propozon rekomandime për përmirësimin e politikave në fushën e inovacionit në biznes;
- Ndihmon në krijimin e një mjedisi të favorshëm për inovacionin;
- Bashkëpunon me aktorët e ekosistemit të “*Inovacion*”-it; për mbështetjen e ndërmarrjeve inovative.
- Aplikon për projekte/thirrje për mbështetjen e NMVM-ve shqiptare.
- Koordinon punën dhe procedurat për promovimin e produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, me qëllim reklamimin dhe lehtësimin eksportit të produkteve “*Made in Albania*”
- Mundëson gjetjen e burimeve të reja të eksporteve në Shqipëri me synim rritjen e vlerës së shtuar;
- Organizon një rrjet komunikimi dhe një sistem shërbimi me organizata partnere për eksport;
- Përkrah dhe udhëzon kompanitë shqiptare për të investuar në përmirësimin e aftësive të tyre drejtuese dhe strategjive të reja të biznesit;
- Bashkëpunon me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit, të vendit dhe të huaja, për të krijuar një sistem shkëmbimi të dhënash;
- Harton raporte në lidhje me vështirësitë dhe pengesat të cilat vështirësojnë rritjen e eksporteve, konkurrencën e lirë shoqëruar me rekomandimet për masat që duhen marrë për eliminimin e këtyre pengesave;
- Menaxhon grantet qeveritare për NMVM shqiptare;

Në përbushjen e detyrave të sipërcituara, vlerësohet se në disa raste ka risk të drejtpërdrejtë për çënimin e integritetit të punonjësve që i kryejnë ato. Konkretisht:

- Gjatë aplikimeve dhe zbatimit të projekteve të financuara nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të shmangen rastet e mundshme të konfliktit të interesit, rekomandohet

të tregohet transparencë në përzgjedhjen e aktorëve pjesë të këtyre projekteve, të tregohet vëmendje gjatë vlerësimit të projekteve për një shpërndarje sa më efektive, eficiente dhe jo diskriminuese të fondeve të akorduara.

- Gjithashtu gjatë ushtrimit të detyrave funksionale që lidhen me organizimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë si objekt mbështetjen me shërbime ndaj bizneseve, punonjësit duhet të jenë gjithëpërfshirës në shpërndarjen e informacionit të zotëruar prej tyre tek të gjitha palët e interesit. Rekomandohet që të përdoren të gjitha kanalet e komunikimit zyrtar të Agjencisë (posta elektronike/faqa zyrtare/rrjete sociale).
- Gjatë menaxhimit të fondeve dhe granteve për NMVM-të, Drejtori Ekzekutiv (Titullari) ngre një komision për shqyrtimin e aplikimeve si dhe hartimin e një raporti vlerësimi për aplikimet, bazuar në sistemin e pikëzimit. Nëpunësit e Agjencisë të përfshirë në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit. Për të shmangur riskun e cenimit të integritetit të nëpunësve/anëtar komisionesh duhet të plotësohet formulari i konfliktit të interesit në përputhje me ligjin në fuqi, përcaktimin e kriterëve të qarta të vlerësimit, respektimi i afateve dhe njoftimi i palëve të përfshira në proces.
- Gjatë koordinimit të punës lidhur me promovimin e produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare/panaire me qëllim reklamimin dhe lehtësimin e eksportit të produkteve “Made in Albania”, njësia përgjegjëse duhet të shmang riskun e cenimit të integritetit në disa aspekte. Konkretisht risqet në këtë proces pune lidhen me objektivitetin në përzgjedhjen e NMVM-ve që do jenë pjesë e panaireve. Ndaj rekomandohet që të tregohet vëmendje në: shpërndarjen e informacionit tek të gjithë subjektet e interesuara, në përcaktimin e kriterëve përzgjedhëse të qarta të NMVM-ve, në mënyrë që të evitohet monopolizimi i pjesëmarrjes nga të njëjtët NMVM, duke ju dhënë kështu mundësi pjesëmarrjeje subjekteve të ndryshme.

- **Drejtoria e Koordinimit** (ose drejtoria/struktura përgjegjëse për mbajtjen dhe koordinimin e marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me departamentet brenda AIDA-s, si dhe kryerjen e matjeve dhe vlerësimit të rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave dhe burimeve).

Duke qenë se konsiderohet drejtorja kryesore e institucionit që ka fokusin primar koordinimin dhe mbarëvajtjen e bashkëpunimit si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në aspektin e jashtëm me institucionet e tjera, vlerësohet me rëndësi që në realizimin e veprimtarisë së saj të veprohet me paanësi, transparencë dhe eficientë.

Në përgjithësi nuk vlerësohet që të ketë risqe të drejtpërdrejta për këtë drejtori. Megjithatë për sigurimin e një performace sa më të mirë, në mënyrë indirekte ka risqe të informimit dhe transparencës për të cilat duhet të tregohet vëmendje që mos preken gjatë procesve të punës.

Gjatë koordinimit me institucionet e tjera është e rëndësishme që të veprohet me shpejtësi dhe eficientë për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përbashkëta. Po ashtu, edhe në raport me koordinimin e departamenteve të AIDA dhe hartimin e dokumenteve kyç të performancës

duhet të realizohet bashkëpunim sa më transparent dhe hartimi i Indikatorëve të Matjes së Performancës (IKP) të bëhet me saktësi dhe vërtetësi.

Të dyja këto aspekte ndikojnë si në riskun e informimit po ashtu edhe në riskun e transparencës.

Gjithashtu kjo njësi në funksion të realizimit të raportimit periodik të brendshëm apo edhe të raportimit ndaj institucioneve të tjera, duhet të sigurohet për dhënien e një informacioni sa më gjithëpërfshirës, të saktë, të shpeshtë, të përditësuar dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Nga ana tjetër, me qëllim që mbarëvajtja e procesit të punës dhe realizimit të bashkëpunimit të jetë sa më e lehtë dhe sa më pak burokratike, është me rëndësi që të mos ketë vonesa në përgjigje, në informimin e institucioneve apo departamenteve të AIDA mbi çështjet që janë të përfshira apo për të cilat duhet të raportojnë.

Për të evituar risqet indirekte të konstatuara për këtë njësi rekomandohet që të intensifikohet koordinimi brenda drejtorive në lidhje me aspektet teknike dhe proceduriale të proceseve të punës për koordinimin, drejtimin dhe realizimin sa më efikas të funksioneve të kësaj drejtorie.

- **Drejtoria e marketing dhe kërkim analize** (ose drejtoria/struktura përgjegjëse për arritjen e objektivit mbi informacionet mbi tregun dhe strategjive të reja, me qëllim kërkimin në vazhdimësi për mundësi të reja investimi në Shqipëri. Drejtoria kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve në funksion të drejtorive dhe investitorëve).

Kjo njësi realizon zhvillimin dhe përgatitjen e marketingut dhe shërbimeve të nevojshme në mbështetje të drejtorive të tjera të AIDA-s.

Funksionet kryesore të Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë janë:

- Sigurimi i komunikimit dhe marketingut të institucionit për politikën, prioritetet, aktivitetet, fushatat, etj.;
- Kërkimi dhe analiza në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë, në përmbushje të ligjit të saj organik;
- Promovimi i Shqipërisë në komunitetin e investitorëve dhe prezantimi i mundësive për investim, pranë investitorëve potencial apo ekzistues.

Nisur nga misioni, objektivat dhe funksionet e drejtorisë, por edhe nga veprimtaria e përditshme e punës e nëpunësve të kësaj drejtorie, është bërë vlerësimi i riskut të integritetit për këtë drejtori, duke përcaktuar dhe planin përkatës. Risku i integritetit në Drejtorinë Marketing dhe Kërkim Analizë lidhet kryesisht me informimin dhe komunikimin.

Më poshtë prezantohet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi për secilin nga risqet e integritetit sipas funksioneve dhe detyrave të drejtorisë.

- **Komunikimi i informacionit**

Drejtoria menaxhon kanalet e komunikimit të AIDA, si faqen zyrtare web: www.aida.gov.al, adresën e email-it: info@aida.gov.al dhe rrjetet sociale të agjencisë. Objekti i informimit publik ka të bëjë me informacionin kryesor mbi veprimtarinë dhe aktivitetet e agjencisë, publikohet në faqen ëeb dhe rrjete sociale në mënyrë të qartë dhe transparente, duke mos lënë hapësirë për keqinterpretim nga palët e interesuara. Në lidhje me transmetimin dhe publikimin e informacioneve mbi bazën ligjore, strategjitë, projektet, publikohen në kohë reale, të kuptueshme dhe me cilësi, duke mos cënuar integritetin e institucionit.

Njoftimi i palëve të interesuara/bizneseve mbi aktivitet që AIDA organizon, ose për aktivitete të organizuara nga partnerët, bëhet në mënyrë transparente, duke njoftuar me anë të email-it, faqes ëeb dhe rrjeteve sociale. Nëpunësit respektojnë të gjitha hapat kyçe, duke njoftuar palët e interesuara në mënyrë të barabartë dhe në kohë reale.

Drejtoria, gjithashtu, publikon dhe përditëson në mënyrë të vazhdueshme informacione të detyrueshme për publikun, në faqen ëeb duke respektuar afatet ligjore, pa cënuar të drejtën për informim.

- Botimet

Drejtoria, përgatit, dizenjon materiale informuese dhe promovuese, duke cituar burimet dhe respektuar të drejtën e autorit, duke marrë konfirmimin paraprak. Informacioni i përfshirë në botimet promovuese janë të marra nga burime të besueshme, duke mos keqinformuar palët e interesuara.

Botimet e publikuara në faqen ëeb të AIDA-s, janë transparente dhe të pa anshme, duke mos favorizuar asnjë përfaqësues/subjekt/aktor. Drejtoria, gjatë procesit të përgatitjes së materialeve promovuese, verifikon materialet/dokumentet dhe të dhënat e përfshira në material përpara publikimit në kanalet zyrtare të komunikimit.

- Marrëdhënia me publikun

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë kujdeset për mbarëvajtjen e marrëdhënieve me publikun, duke respektuar dhe ruajtur konfidencialitetin, si dhe respektuar të drejtën për informim. Të gjitha komunikimet dhe informaciont e dhëna publikut, janë të gjeneruara nga veprimtaria dhe puna e agjencisë, në mënyrë të saktë dhe reale. Gjatë dhënies së informacioneve dhe përgjigjeve të kërkesave për informim, nëpunësit e drejtorisë ruajnë konfidencialitetin e subjektit kërkues.

- Kërkimi dhe analiza e variablave

Në realizimin e funksionit të kërkimit dhe analizës së variablave që AIDA ka në fokus, drejtoria fokusohet kryesisht në nivelin e të dhënave makroekonomike, por gjithashtu realizohen dhe studime për çështje më specifike.

Kërkimi i të dhënave makroekonomike bazohet në publikimet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë burime të besueshme të informacionit, më tej realizohet analiza e të dhënave të identifikuar me qëllim përcaktimin e trendeve dhe më tej propozimin e masave që duhen ndjekur. Në kërkimin e këtyre të dhënave, nuk ka rrisje të identifikuar që cënojnë integritetin e nëpunësve, pasi kërkimi bazohet vetëm në burime të besueshme dhe zyrtare.

Për sa i përket analizimit të variablave, vlerësohet se ky proces trajtohet në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale, duke qenë e rëndësishme pasi kjo ndikon në integritetin e vetë institucionit. Më tej, në realizimin e studimeve për çështje specifike sipas rastit, vlerësohet se në të gjitha etapat e realizimit të studimit, ruhet integriteti dhe nuk ka risqe të identifikuar.

- **Kujdesi për identitetin dhe imazhin e AIDA-s**

Drejtoria në realizimin e çdo funksioni të saj, është përgjegjëse dhe kujdeset për ruajtjen e identitetit dhe imazhit të agjencisë. Për të transmetuar identitetin e AIDA, janë krijuar logo dhe slogane që komunikojnë në mënyrë koherente atë që agjencia përfaqëson.

Në çdo komunikim, promovim dhe marketim të AIDA, përdoret brandimi i unifikuar dhe procedura tepër korrekte për të transmetuar dhe duke ruajtur në çdo moment imazhin e agjencisë. Nga vlerësimi i kryer, rezulton se çdo nëpunës është tepër i kujdesshëm dhe i përpiktë në ruajtjen e imazhit të AIDA dhe si rrjedhojë, nuk identifikohet risk në këtë fushë.

Në përfundim vlerësohet se, Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë në fushat ku mund të ishte e prekur nga risku i integritetit nuk ka risk. Drejtoria ka arritur t'i menaxhojë si duhet proceset duke patur një plan efektiv integriteti.

- **Drejtoria e Investimeve** (ose drejtoria/struktura përgjegjëse për zhvillimin e një imazhi pozitiv për klimën e biznesit në Republikën e Shqipërisë dhe tërheqjen e investimeve të brendshme dhe të huaja).

Ligji nr. 55/2015, hyrë në fuqi më datë 01 janar 2016 ka synuar rritjen e investimeve strategjike vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë të konsideruar si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve.

AIDA në funksionin e dritares unike, zhvillon shërbime të promovimit, nxitjes dhe tërheqjes së investimeve strategjike duke promovuar klimën e biznesit, procedurat lehtësuese, masat mbështetëse dhe kuadrin ligjor favorizues për investimet strategjike, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të asistuar dhe ndjekur këto procedura, referuar strukturës organizative të AIDA-s, është ngarkuar Drejtoria e Investimeve.

Objektivi i Drejtorisë së Investimeve është zbatimi i politikave të Qeverisë Shqiptare në lidhje me mbështetjen e investimeve, hartimin dhe propozimin e masave mbështetëse që synojnë realizimin e suksesshëm të politikave për promovimin e investimeve. Funksionet kryesore të drejtorisë janë:

- asistimi dhe mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investim;
- ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes dhe mbështetjes së investitorëve ekzistues ose potencialë;
- asistimi dhe mbështetja me procedura të përshpejtuara të investimeve strategjike në Republikën e Shqipërisë.

Duke qenë se Drejtoria e Investimeve konsiderohet një nga shtyllat kryesore të institucionit dhe ka impakt të drejtpërdrejtë në imazhin e tij në tërësi, vlerësohet e rëndësishme që të veprohet me saktësi, paanësi dhe përgjegjshmëri në drejtim të menaxhimit në tërësi të proceseve administrative dhe kryerjes me përgjegjshmëri të funksioneve të veta ligjore. Nga vlerësimi i kryer, nuk janë identifikuar risqe të drejtpërdrejta për këtë strukturë, për sa kohë që funksionet e saj nuk janë të karakterit vendimmarrës. Megjithatë, duke pasur parasysh edhe faktin se qysh prej ndryshimit të strukturës organizative të saj, AIDA nuk e ka përshtatur rregulloren e funksionimit me detyrat dhe funksionet konkrete që ka kjo Drejtori sipas ligjit dhe akteve nënligjore, rekomandohet rishikimi i rregullores së funksionimit dhe organizimit të AIDA-s, në mënyrë që funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Investimeve të rregullohen sipas ligjit dhe akteve nënligjore përkatëse, duke siguruar kështu një përmbushje më cilësore të detyrave dhe përgjegjësive në funksion të trajtimit të projekteve konkrete të investimeve.

3. RISQE TË PËRGJITHSHME

Gjatë hartimit të këtij dokumenti strategjik, janë identifikuar disa risqe, të cilat mund të çenojnë integritetin e cilitdo prej nëpunësve të Agjencisë. Kështu, janë cilësuar risqet që vijnë nga rastet e konfliktit të interesit, rastet e shkeljes së rregullave të brendshme të Kodit të Etikës dhe rastet e shkeljes së normave të transparencës, informimit dhe vlerësimit të aplikimeve.

3.1 Risqet lidhur me konfliktin e interesit

Për parandalimin e konfliktit të interesit, vihet re se nuk ka një strukturë të veçantë, por legjislacioni njihet nga ana e nëpunësve publikë. Fillimisht bëhet me dije se, burimet njerëzore të institucionit i kërkojnë çdo nëpunësi civil apo nëpunësi me kontratë, të punësuar rishtazi, që të njihet dhe nënshkruajë aktin zyrtar në lidhje me përdorimin e të dhënave personale, si dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Kjo i shërben periudhës së punësimit të nëpunësit, për zbatimin në mënyrën e duhur të legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit, me qëllim ruajtjen e integritetit të nëpunësve. Në vijim të kësaj procedure, konstatohet se një autorizim i tillë ka vlerë në çdo kohë, por vetëm për ato të dhëna të interesave private të nëpunësit, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike, në kohën e ushtrimit të saj.

Për sa i përket procedurave të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e konkurrimeve, prokurimeve, tenderave, apo procedurave të ngjashme, në të cilat nëpunësi rol vendimmarrës apo të drejtë vote, konstatohet se ky i fundit njihet me legjislacionin në fuqi dhe merr masat e duhura për të vepruar në përputhje me ligjin. Për këtë, rekomandohet që të vijojë të ndiqet e njëjta metodë e përdorur derimë tani, për njohjen e nëpunësve në cilësi të tilla me klauzolën e parandalimit të konfliktit të interesit, duke qenë se nuk janë evidentuar risqe integriteti.

3.2 Risqet lidhur informimin

Referuar legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, Agjencia përfaqësohet nga një nëpunës, që ushtron detyrën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Nga informacioni i siguruar rezulton se nuk ka patur raste të patrajuara nga AIDA për zbatimin e këtij detyrimi ligjor. Në faqen zyrtare të Agjencisë sipas seksioneve respektive janë të botuara informacione referuar kërkesave ligjore në fuqi. Përditësimi i tyre kryhet rregullisht nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit.

Rekomandohet që në faqen e AIDA të gjitha njësit përbërëse të saj të përditësojnë informacionin që gjykojnë se është i nevojshëm për të aksesuar nga palët e treta.

3.3 Risqet lidhur me transparencën

Për sa i përket transparencës, agjencia vazhdimisht publikon shpallje në faqen zyrtare të saj njoftime për subjektet e interesuara për të aplikuar për të përfituar grante, për thirrjet për aplikim (*referuar aktiviteteve që lidhen me projekte financimi*), njoftimet për vende vakante pune, aktivitete që priten të mbahen për të ardhur në ndihmë ndaj NMVM-ve etj.

Ruajtja e stabilitetit në kuadër të transparencës së informacionit të transmetuar për të tretët, kërkon një angazhim të lartë nga njësit e AIDA-s. Njësit e agjencisë duhet të tregohen pro aktive dhe të dërgojnë për publikim dhe për transmetim informacionet që gjykojnë të nevojshme për palët e treta. Ky angazhim duhet të jetë pjesë e fokusit të punës së çdo njëpunësi të AIDA-s dhe jo të diktohet herë pas here nga Drejtoria e Marketingut dhe Analizës.

Për këtë arsye, rekomandohet që të ketë angazhim dhe bashkëpunim ndërmjet drejtorive politikëbërëse dhe drejtorisë përgjegjëse për teknologjinë e informacionit, për përditësimin e vazhdueshëm të informacioneve të nevojshme.

3.4 Risqet lidhur me etikën

AIDA, me urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 172, datë 18.12.2019, ka miratuar kodin e brendshëm etik të institucionit, ku përcaktohen në mënyrë eksplicite detyrimet e punonjësve për ta bazuar veprimat e tyre në vlera etike dhe me integritet të lartë.

Aktualisht nga analiza e kryer nuk rezulton që Agjencia të ketë raste të shkeljeve të etikës në kryerjen e detyrave funksionale apo në sjelljet institucionale të punonjësve në raport me palët e treta.

Gjithësesi rekomandohet të ruhet niveli i lartë i integritetit nga nëpunësit e AIDA-s për të mos cënuar etikën në komunikimet me palët e treta dhe në transmetimet e informacionit në dobi të tyre.

3.6 Risqet lidhur me korrupsionin

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit është trajtuar korrupsioni veçanërisht për drejtoritë që kanë risk, të cilat e kanë të parashikuar në legjislacionin që kryejnë funksionet e tyre. Megjithatë, në zbatim të ligjit nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, rekomandohet që çdo nëpunësi t’i bëhet e njohur se nuk duhet të kërkojë ose të pranojë dhurata,

favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare. Gjithashtu nuk duhet të pranohen në çfarëdo lloj mënyre apo forme, direkte apo indirekte, dhuratat, premtime, favore, trajtime preferenciale, negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e nëpunësit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për nëpunësin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës. Këto informacione mundësohet dhe mund të theksohen edhe me tej, nëpërmjet trajnimeve që siguron Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

5. PLANI I VEPRIMIT

5.1 Përmbledhje

Në përfundim të hartimit të Planit të Integritetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të figurës së nëpunësit, ruajtjen e profesionalizmit, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi në fushën e financave publike, auditimit dhe kontrollit, burimeve njerëzore, arkivimit të dokumentacionit dhe me gjerë, menaxhimin e përshtatshëm dhe të duhur të fondeve publike, përcaktohet se **punonjësit e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve duhet të konsiderojnë që:**

- 1) Të karakterizohen nga ndershmëria dhe përkushtimi në kryerjen e detyrave, duke zbatuar me rreptësi rregullat që normojnë disiplinën në punë;
- 2) Të ruajnë reputacionin, dinjitetin si dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi që mund të çënojë emrin e mirë të tyre apo të institucionit, duke ruajtur të pastër figurën e tyre morale dhe duke shmangur sjellje apo veprime, të cilat çënojnë autoritetin dhe imazhin e tyre para opinionit publik;
- 3) Të reflektojnë standarde të larta të integritetit profesional e personal në ushtrimin e detyrave të tyre, për të siguruar funksionimin sa më transparent, të ndershëm, të drejtë dhe të përgjegjshëm, të fushës së përgjegjësisë së institucionit;
- 4) Të garantojnë mbrojtjen e interesit publik në gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të kompromentojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut;
- 5) Të shmangin sjellje të paqarta dhe të dyshimta apo çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, kombësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose për çdo shkak tjetër.
- 6) Të njihen personalisht me përkrahimin e punës që do të kryejnë sipas pozicionit, duke iu përmbajtur përcaktimeve të tij;
- 7) Të ndërveprojnë në marrëdhënie me njëri –tjetrin me frymën e bashkëpunimit, respektit reciprok, komunikimit korrekt, sjelljes së përshtatshme etj.
- 8) Të njihen me përditësimet ligjore apo administrative të legjislacionit në fuqi lidhur me Kodin e Punës, si dhe Kodin Etik të AIDA-s;
- 9) Të mbajnë në konsideratë parimet bazë të veprimtarisë së institucionit;

- 10) Të mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve gjatë ushtrimit të detyrës;
- 11) Të njihen me procedurat e sinjalizimit;
- 12) Të respektojnë dispozitat ligjore që rregullojnë konfidencialitetin, informimin publik, konsultimin publik dhe transparencën;
- 13) Të deklarojnë çdo rast të konfliktit të interesit;
- 14) Të respektojnë parimin e trajtimit të barabartë të rasteve, subjekteve apo qytetarëve, parimin e mosneglizhencës së rasteve, parimin e zbatimit të kërkesave ligjore dhe afateve ligjore apo afateve të tjera të caktuar në akte nënligjore;
- 15) Të mos kërkojnë apo të mos pranojnë dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
- 16) Të mbajnë në konsideratë forcimin e integritetit institucional, si dhe forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

5.2 Monitorimi

Monitorimi i ndjekjes së Planit të Integritetit apo zbatimit të rekomandimeve të dhëna do të kryhet periodikisht dhe përfshin aktivitete nga ana e nëpunësve të ngarkuar me këtë qëllim. Procesi synon të përcaktojë nëse është e nevojshme marrja e masave, nëse janë evidentuar ndryshime të risqeve, si dhe nëse ka kërkesa për rishikim.

Aspekte të tilla si shpenzime, alokim buxheti, masa disiplinore, hetime administrative, do të trajtohen rast pas rasti, nga struktura që ka në fushën e saj të përgjegjësisë çështjen në fjalë, nga personi i ngarkuar ose nga grupi i punës (monitorues, raportues, auditues etj).

Të gjitha aktivitetet që ndërmerren në kuadër të Planit të Integritetit të Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve do t'i njoftohen Drejtorit Ekzekutiv dhe strukturës së brendshme që menaxhon burimet njerëzore.

Tabela e masave kundër riskut të integritetit për AIDA (Viti 2023-2025)

Nr	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse					Të përcaktohet afati zbatimit për cdo masë të planit,
I	Vështirësi në prodhimin e informacionit financiar dhe raportimi jo në kohë i tij	Operacional	I lartë	Parashikimi në PBA i futjes së një sistemi financiar (soft) për mbajtjen e kontabilitetit në mënyrë që informacioni financiar të jetë më i aksesueshëm	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse Afati Brenda muajit prill 2024
II	Mungesa e një kalendari parashikimesh vjetore për nevojat për trajnime të stafit të AIDA-s dhe mungesa e kostimit të tyre	Financiar dhe operacional	I mesëm	I. Hartimi i një dokumenti tip, për tu plotësuar me të dhënat e neovjshme për kërkesat për trajnime: II. Plotësimi nga njësitë e AIDA-s i dokumentit tip dhe kostimet respektive	Drejtori Ekzekutiv, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Njësitë e AIDA-s Dhjetor 2023

III	Konstatimi i konfliktit të interesit	Reputacional	I lartë	I.Njohja me ligjin për “Konfliktin e Interesit” II. Plotësimi i formularit “Për konfliktin e Interesit”, në momentin e punësimit dhe në restet e tjera të parashikuara në ligj. II	Drejtori Ekzekutiv, Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, Njësitë e AIDA-s
IV	Vështirësi në ruajtjen fizike të informacionit në fondin e arkiës të AIDA-s dhe risku për humbjen e tij	Operacional	I lartë	Hartimi i një Rregulloreje të Brendshme për përcaktimin e mënyrës së qarkullimit të shkresave zyrtare dhe të administrimit të tyre nga punonjësit deri në procesin e arkivimit të praktikave në përfundim të administrimit të tyre	Grup pune për hartimin e Rregullores Dhjetor 2023
Drejtorja e NVM dhe Projekte					
I	Mungesa e transparencës në përzgjedhjen e aplikantëve për projekte, si dhe mos shpërndarja në mënyrë efektive, eficiente dhe diskriminuese të fondeve të akorduara.	Reputacional dhe Financiar	I lartë	II. Dokumentimi i aplikimeve të depozituara në rrugë zyrtare, Cdo aplikim, do të ketë numrin e tij të protokollit. III. Mbajtja e komunikimeve të vazhdueshme me NVMV-t mbi Cdo informacion i nevojshëm do të behet në rrugë zyrtare: elektronike, shkresore. vijmësinë e procesit. IV. Respektimi i të drejtës për përgjigje. Cdo aplikim, ruan të drejtën e përgjigjes brenda afateve të përcaktuara	Drejtorja e NVM dhe Projekteve, Grupet e Punës, Drejtorja e Marketing dhe Kërkim Analizës 2024-2025

			Mbajtja e një regjistri të posaçem në zyrën e Arshive-Protokollit, për regjistrimin e protokolluar të ndërmarrjeve aplikuese.	
II	<u>Mos përcaktimi qartë i kriterëve të vlerësimit, mosrespektimi i afateve procedurale dhe mos njoftimi i palëve të përfshira në proces.</u>	Operacional	I lartë	<p>I. Grupet e punës të ngritura për hartimin e kriterëve të vlerësimit të kenë në përbërje ekspertë të fushës;</p> <p>II. Publikimi i informacionit të nevojshëm për grupet e interesit;</p> <p>III. Njoftimi i palëve të përfshira në proces</p> <p>Drejtoria e NVM dhe Projekteve, Grupet e Punës, Drejtoria e Marketing dhe Kërkim Analizës</p> <p>2024-2025</p>
III	Monopolizimi i përfaqësimit në panairë Kombëtare dhe Ndërkombëtare nga të njëjtët NVMV	Reputacional dhe Financiar	I lartë	<p>I. Rritja e transparencës në shpërndarjen e informacionit. Informacioni për pjesëmarrje në panairë kryhet në rrugë zyrtare, përmes rrjeteve sociale të AIDA-s, si dhe përmes aktoreve të biznesit, shoqatave dhe organizatave të sektoreve përkatëse</p> <p>II. Përcaktimi i kriterëve përzgjedhëse për NVMV-t pjesëmarrëse në panairë;</p> <p>III. Shmangia e konfliktit të interesit Plotësimi i formularit të konfliktit të interesit nga anëtarët e Komisionit të vlerësimit të NVMV-ve.</p> <p>Drejtoria e NVM dhe Projekteve, Grupet e Punës, Drejtoria e Marketing dhe Kërkim Analizës</p> <p>2023-2025</p>

	<p>I.Mos realizimi i publikimeve ose realizimi i tyre jo në afat dhe cilësi në faqen web dhe në rrjetet sociale</p> <p>II.Njoftimi i diferencuar i palëve të interesuara mbi aktivitetet që mbulon institucioni</p> <p>III.Mos informimi i publikut sipas afateve dhe dispozitave ligjore</p>	<p>Reputacional dhe operacional</p>	<p>I moderuar</p>	<p>Përditësimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i kanaleve të komunikimit si faqja zyrtare web: www.aida.gov.al, adresën e email-it: info@aida.gov.al dhe rrjetet sociale të agjencisë, në çdo ditë të punës, duke u kontrolluar paraprakisht nga stafi kompetent dhe raportuar tek Drejtori i Drejtorisë/Drejtori Ekzekutiv</p> <p>II.Publikimi i informacioneve dhe njoftimeve në kohë reale, të kuptueshme dhe me cilësi çdo ditë të punës, duke raportuar tek Drejtori i Drejtorisë/Drejtori Ekzekutiv</p> <p>III.Njoftimi i palëve të interesuara në mënyrë të barabartë, në kohë reale, në çdo ditë të punës, duke raportuar tek Drejtori i Drejtorisë/Drejtori Ekzekutiv</p> <p>IV.Sigurimi i respektimit të së drejtës për informim, duke respektuar afatet ligjore, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës dhe raportimi tek eprori mbi kërkesën dhe dhënien e përgjigjes</p>	<p>Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë</p> <p>Kordinatori për të Drejtën e Informimit</p> <p>2023-2025</p>
--	---	-------------------------------------	-------------------	---	---

II	I.Përfshirja e informacioneve jo të besueshme, jo të sakta dhe favorizuese në botimet e realizuara nga agjencia	Reputacional dhe operacional	I moderuar	I Përfshirja e vazhdueshme e informacioneve të besueshme dhe të sakta nga AIDA, duke përdor burime të besueshme si dhe duke respektuar të Drejtën e Autorit II.Botimet të vijojnë të jenë transparente dhe të paanshme, duke mos favorizuar asnjë përfaqësues/subjekt/aktor, sikurse AIDA e ka të përcaktuar në Statut dhe në Rregulloren e brendshme	Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë 2023-2025
III	I.Mos respektimi i konfidencialitetit dhe të drejtës për informim në marrëdhënien me publikun	Reputacional	I moderuar	Veprimtaria e AIDA-s bazuar në Kodin e Etikes, të vijojë me ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve të siguruara, për shkak të detyrës, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, mbështetet në integritetin, pavarësinë, objektivitetin dhe paanshmërinë, ruajtjen e sekretit profesional, kompetencat dhe kujdesin e duhur.	Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë Kordinatori për të Drejtën e Informimit 2023-2025
IV	I.Kërkimi i të dhënave duke u bazuar në burime jo të besueshme II.Analizimi i variablave të kërkimit në mënyrë të anshme dhe jo profesionale	Reputacional dhe operacional	I moderuar	Kërkimi i të dhënave në rrugë zyrtare me infomacion nga (INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministrinë e linjës, Banka Botërore, OECD, etj.) II.Analizimi i variablave bazohet vetëm në të dhënat e marra nga institucionet e certifikuara në vend dhe trajtohen sipas sektorëve në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale	Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë 2023-2025

V	I.Dëmtimi i identitetit dhe imazhit të agjencisë	Reputacional dhe operacional	I moderuar	<p>Të vijohet me zbatimin e planit operacional të marketingut dhe të komunikimit i cili synon të forcojë imazhin e Shqipërisë si një vend i favorshëm për investimet dhe biznesin.</p> <p>Zbatimin e Rregullores lidhur me organizimin dhe funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm për sa i takon imazhit të agjencisë si dhe me Kodin e Etikës që standartizon zbatimin e rregullave për reputacionin e institucionit gjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë lidhur me integritetin</p>	<p>Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë</p> <p>2023-2025</p>
---	--	------------------------------	------------	--	--

Drejtoria e Koordinimit

I	Koordinimi i procesit të bashkëpunimit midis drejtorive të AIDA dhe insitucioneve të tjera për realizimin e objektivave	Reputacional	I moderuar	Përgatitja e Raportit Vjetor për realizimin e objektivave dhe publikimi në faqen zyrtare të AIDA-së.	<p>Drejtoritë e AIDA-s Drejtoria e Koordinimit</p> <p>Në Mars të çdo viti</p>
---	---	--------------	------------	--	---

Drejtoria e Investimeve

I	Mungesa e miratimit të rregullores së funksionimit dhe organizimit të AIDA-s,	Operacional	I mesëm	Rishikim i detyrave dhe funksioneve të njësisë të AIDA-s sipas zhvillimeve dhe angazhimeve të reja të AIDA-s, duke mos harruar dhe riorganizimin strukturor të saj prej vitit 2019	Drejtoritë e AIDA-s Gjate 6 mujorit të I-r të 2024
---	---	-------------	---------	--	---